

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8326
E martë, 23 qershor 2026
Çmimi 0.50 €

Emini: Kosova po pret nga BE-ja, por pa lobim nuk ka lëvizje | F. 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

'PAGA KALIMTARE': MBI 150 MIJË EURO NË MUAJ PËR ISH-DEPUTETËT

F. 4-5



Dhjetëra ish-deputetë të Kosovës përfitojnë nga 1 914 euro në muaj pa e ushtruar këtë

funkcion publik. Edhe pse paga kalimtare është e garantuar me ligj, ekspertët e shohin të pajus-

tifikueshme nga pikëpamja etike dhe kërkojnë rishikim të skemës

AKTUALE



**JEP DORËHEQJE KRYEMINISTRI
BRITANIK KEIR STARMER** F. 2

**EVROPA NË VALËN E TË
NXEHTIT: TEMPERATURA
DERI NË 44 GRADË** F. 5

**40 RASTE ME FRUTH NË KOSOVË,
IKSHPK BËN THIRRJE PËR
VAKSINIM TË FËMIJËVE** F. 6

EKONOMI



**NGRITJA E TEMPERATURAVE,
A DO TË RIKTHEHET VENDIMI
QË KUFIZON ORARIN E PUNËS?** F. 8

**MË SHUMË SIPËRFAQE E SHFRY-
TËZUAR E TOKËS BUJQËSORE MË
2025 SESA MË 2024** F. 8

SPORT



**AAMIR SHAIPI PRITET
TË TRANSFEROHET NË TURQI** F. 11



**SHBA-ja DHE IRANI JANË
PAJTUAR PËR NJË PLAN DREJT
ARRITJES SË MARRËVESHJES
PËRFUNDIMTARE,
THONË NDËRMJETËSIT** F. 3



**PACOLLI KËRKON
HETIM NGA SPAK-U:
AEROPORTI I
VLOBËS U UZURPUE
NGA GRUPE
KRIMINALE
PËR 10 MUAJ** F. 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@ml.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SHBA-ja DHE IRANI JANË PAJTUAR PËR NJË PLAN DREJT ARRITJES SË MARRËVESHJES PËRFUNDIMTARE, THONË NDËRMJETËSIT

WASHINGTON, 22 QERSHOR - Ndërmjetësit nga Pakistani dhe Katarit deklaruan më 22 qershor se negociatat mes ShBA-së dhe Iranit kanë përfunduar, me të dyja palët që kanë rënë dakord për një kornizë drejt arritjes së një marrëveshjeje përfundimtare paqeje brenda 60 ditëve, që përfshin garantimin e kalimit të sigurt përmes Ngushticës së Hormuzit dhe përfundimin e luftimeve në Liban.

Pak detaje konkrete u bënë publike në një deklaratë të përbashkët të Katarit dhe Pakistanit. Marrëveshja duket se pasqyron objektivat e përgjithshme të përcaktuara në një memorandum mirëkuptimi të nënshkruar javën e kaluar nga presidenti i ShBA-së dhe ai i Iranit.

Ai memorandum la të hapura për interpretim shumë prej termave të një marrëveshjeje

me 14 pika. Nuk ishte menjëherë e qartë nëse ato çështje ishin sqaruar në marrëveshjen më të fundit.

Deklarata tha se, ndërsa negociatat formale kishin përfunduar në qytezën turistike zvicerane të Byrgenstokut, diskutime të mëtejshme teknike do të zhvillohen nga delegacionet gjatë javës së ardhshme.

Ajo tha se do të krijohen "grupe pune" për t'i trajtuar çështjet "bërthamore, sanksionet dhe një grup për monitorim dhe zgjidhje të mosmarrëveshjeve për ta siguruar zbatimin efektiv të memorandumit të mirëkuptimit si dhe për çështje të tjera".

Zyrtarët amerikanë nuk komentuan menjëherë.

Ministria e Jashtme e Iranit, në deklaratë të raportuara nga media shtetërore iraniane, tha se bllokada amerikane e porteve



ishte hequr, se "disa asete të ngrira" ishin liruar dhe se ishte nisur një "plan i madh zhvillimor për rindërtimin e Iranit".

Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit tha se, lidhur me kalimin e sigurt të anijeve përmes Ngushticës së Hormuzit, "u ra dakord të organizohet një mekanizëm", pa dhënë hollësi të mëtejshme.

Më herët, ndërsa ora po i afrohej mesnatës, një diplomat i lartë

amerikan tha se ekipet amerikane dhe iraniane do të punonin "gjatë gjithë natës" në përpjekje për ta shndërruar memorandumin e mirëkuptimit në një zgjidhje të përhershme ushtarake dhe politike. Zyrtarët thanë se bisedimet zgjatën 18 orë.

Marrëveshja, dhe veçanërisht dakordimi për ngritjen e një fondi rindërtimi si dhe mungesa e qartësisë mbi programin bërthamor të Iranit, është pritur

me zemërim nga demokratët amerikanë dhe nga shumë republikanë. Përveç kësaj, shumë udhëheqës izraelitë kanë deklaruar se vendi nuk është palë në marrëveshje dhe janë zotuar t'i vazhdojnë sulmet ndaj objektivave të Hezbollahit në Liban.

Hezbollahu, një grup militant dhe parti politike e mbështetur nga Irani që kontrollon pjesën më të madhe të Libanit jugor, konsiderohet organizatë terroriste nga ShBA-ja, ndërsa Bashkimi Evropian e ka futur në listën e zezë krahun e tij ushtarak, por jo degën e tij politike.

Raportet kanë sugjeruar se kundërshtimi nga disa fraksione të vijës së ashpër brenda Iranit - përfshirë Korpusin e Gardës Revolucionare Islamike (IRGC) - ka ushtruar presion shtesë mbi ekipet negociuese të Teheranit.

JEP DORËHEQJE KRYEMINISTRI BRITANIK KEIR STARMER

LONDËR, 22 QERSHOR - Kryeministri britanik Keir Starmer tha se do të japë dorëheqje nga pozita e kryeministrit dhe nga ajo e udhëheqësit të Partisë Laburiste. Ai u zotua se do të bëjë gjithçka që është në dorën e tij për të garantuar një transferim të rregullt të pushtetit.

Duke folur para Zyrës së Kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar në Londër, e njohur si Downing Street 10, ai tha se marrja e detyrës, dy vjet më parë, ishte "momenti më krenar" i jetës së tij. Ai tha se u fut në politikë për të pasur mundësinë që ta përmirësojë jetën e miliona njerëzve dhe shtoi se çdo vendim i tij ka pasur për qëllim të vendosë në plan të parë "vendin që e do".

Starmer mori pushtetin pas zgjedhjeve të përgjithshme më 4 korrik 2024, kur Laburistët fituan bindshëm dhe u dhanë fund 14 vjetëve të qeverisjes konservatore.

Ai tha se procesi për zgjedhjen e pasardhësit do të fillojë më 9 korrik, ndërsa rivali i tij, Andy Burnham, shihet si kandidati kryesor. "Pyetja që partia ime po më bën tani është nëse unë jam personi më i përshtatshëm për të na udhëhequr në zgjedhjet e ardhshme të përgjithshme. Unë e kam dëgjuar përgjigjen



e grupit tim parlamentar për këtë pyetje dhe e pranoj atë me mirësi", tha Starmer.

Largimi i tij e çon Britaninë drejt liderit të saj të shtatë në dhjetë vjetët e fundit.

Presioni në rritje

Presioni ndaj Starmerit ishte rritur prej muajsh, por u thellua të premten e kaluar, kur Andy Burnham, kryetar i bashkisë Greater Manchester, fitoi bindshëm një zgjedhje

parlamentare për t'u rikthyer në Uestminster, apo Parlamentin britanik. Ai mposhti një kandidat nga partia Reform UK e Nigel Farage, e cila ka kryesuar sondazhet kombëtare për më shumë se një vit. Kjo fitore forcoi bindjen brenda Laburistëve se Burnham - një politikan me përvojë dhe aftësi të forta komunikimi - mund ta ringjallë partinë, e cila ka humbur mbështetjen nën drejtimin e Starmerit.

Starmer i falënderoi kolegët e

tij për mbështetjen dhe tha se, pas largimit nga "postu më i madh në vend", do të kalojë më shumë kohë në "detyrën më të rëndësishme". "Të jem bashkëshorti më i mirë që mundem për gruan time të jashtëzakonshme Vic, e cila ka qenë një mbështetje e fortë e imja në kohë të mira dhe të vështira", tha ai. "Dhe, të jem babai më i mirë që mundem për fëmijët e mi të mrekullueshëm, të cilët janë krenaria dhe gëzimi im", shtoi kryeministri në largim, duke

përqafuar bashkëshorten e tij përpara se të kthehej brenda në Downing Street 10.

Starmeri dhe Ballkani Perëndimor

Starmeri e ka cilësuar Ballkanin Perëndimor vend ku testohet siguria e Evropës. Duke mirëpritur Samitin e Procesit të Berlinit në tetor të vitit të kaluar, ai ka thënë se Ballkani Perëndimor për një kohë të gjatë ka qenë rrugë transiti për bandat kriminale të kontrabandës. "Nuk do të dëshironit që këto banda të operonin në territorin tuaj, sepse do t'i vuanit pasojat e veprimeve të tyre", ka thënë ai atëkohë.

Gjatë një vizite në Tiranë në maj të vitit të kaluar, Starmeri ka paralajmëruar se Britania e Madhe do t'i shtojë përpjekjet për t'i luftuar rrjetet kriminale në mbarë Ballkanin Perëndimor të cilat lehtësojnë emigrimin e paligjshëm.

Në vitin 2022 shqiptarët ishin grupi më i madh i migrantëve që mbërrinin në Britani me varka të vogla, por që atëherë ky numër është ulur dukshëm, pjesërisht si pasojë e një marrëveshjeje për dëbim të nënshkruar nga qeveria e mëparshme konservatore.

PACOLLI KËRKON HETIM NGA SPAK-u: AEROPORTI I VLORËS U UZURPUA NGA GRUPE KRIMINALE PËR 10 MUAJ

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Afaristi Behgjet Pacolli ka bërë thirrje publike që SPAK-u në Shqipëri të nisë hetime të menjëhershme dhe të plota lidhur me situatën në Aeroportin e Vlorës, duke pretenduar se projekti është përbullur me bllokadë të paligjshme, vandalizëm dhe dëmtime të mëdha materiale. Në "Facebook", Pacolli tha se kompania MABCO dhe nënkontraktorët e saj janë rikthyer në kantier pas muajsh bllokade, në përputhje me vendimet gjyqësore, ndërsa aktualisht po bëhet verifikimi i dëmeve të shkaktuara gjatë kësaj periudhe. Sipas tij, dëmet përfshijnë inventarin e aeroportit, pajisje të specializuara, instrumente pune dhe prona të kompanive nënkontraktuese. "Ju, qytetarë të nderuar, keni të drejtën të informoheni mbi të vërtetën. Fatkeqësisht, ende nuk jeni njohur me gjendjen reale në Aeroportin e Vlorës. Për këtë arsye, i bëj thirrje urgjente SPAK-ut të nisë menjëherë hetime të plota mbi këtë skandal të rëndë, të krijuar dhe ushqyer nga individë që kanë vepruar dhe vazhdojnë të veprojnë në kundërshtim me ligjin, duke cenuar rëndë shtetin e së drejtës dhe sistemin juridik të Republikës së Shqipërisë. Koha për të zbardhur të vërtetën dhe për të

vënë përgjegjësit para drejtësisë është tani. Pas muajsh të tërë bllokade të paligjshme dhe uzurpimi të Terminalit të Vlorës nga grupe kriminale, sot MABCO dhe nënkontraktorët tanë kanë mundur të rikthehen në vendet e tyre të punës. Në këto momente po kryhet verifikimi dhe evidentimi i dëmeve të shkaktuara nga vandalizmi, vjedhjet dhe shkatërrimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe", ka shkruar Pacolli në "Facebook".

Ai ka thënë se dëmet e konstatuara përfshijnë si inventarin e çmuar, të projektuar, porositur, prodhuar dhe instaluar posaçërisht për funksionimin e aeroportit, ashtu edhe instrumentet, pajisjet dhe mjetet e punës që përbëjnë pronë private të kompanive nënkontraktuese. "Për më shumë se dhjetë muaj, këto grupe kriminale kanë vepruar në kundërshtim flagrant me ligjin, me metoda të papranueshme dhe çnjerezore, duke cenuar jo vetëm pronën private, por edhe rendin juridik dhe sigurinë e investimeve. Më shqetësues është fakti se veprimtaria e tyre dyshohet se është mbështetur ose toleruar nga individë që fshihen pas petkut institucional, ndërsa në raste të caktuara kanë tentuar të ndikojnë edhe procese gjyqësore, duke sfiduar hapur sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Sot, në emër të ligjit, të drejtësisë



dhe të besimit që qytetarët shqiptarë dhe partnerët ndërkombëtarë duhet të kenë tek institucionet e shtetit, i bëj thirrje publike SPAK që të nisë menjëherë një hetim të plotë, të pavarur dhe gjithëpërfshirës për të gjitha ngjarjet kriminale të ndodhura gjatë kësaj periudhe, pa asnjë dallim dhe pa asnjë mbrojtje për askënd, pavarësisht pozitës, ndikimit apo lidhjeve që mund të ketë", ka theksuar Pacolli, duke shtuar se është e

domosdoshme të identifikohet dhe të vihet përpara përgjegjësisë i gjithë zinxhiri i personave të përfshirë në këto veprime të rënda të cilat kanë dëmtuar interesin publik, sigurinë juridike dhe imazhin e Shqipërisë si një vend që garanton shtetin e së drejtës dhe mbrojtjen e investimeve. "Po aq e rëndësishme është që institucionet kompetente të marrin masa të menjëhershme për të parandaluar çdo

përkallëzim të mundshëm të situatës dhe për të garantuar sigurinë e punonjësve, të kompanive kontraktuese dhe të çdo qytetari që beson tek puna, ligji dhe vlerat e një shoqërie të qytetëruar. Ne do të vazhdojmë të mbrojmë me vendosmëri të drejtat tona ligjore, pronën tonë dhe dinjitetin e njerëzve të punës, duke besuar se e vërteta dhe drejtësia do të mbizotërojnë", ka thënë Pacolli.

EMINI: KOSOVA PO PRET NGA BE-ja, POR PA LOBIM NUK KA LËVIZJE

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Analistja politike dhe aktivistja e shoqërisë civile, Donika Emini, vlerëson se Kosova nuk po e shfrytëzon një moment të rëndësishëm politik në Bashkimin Evropian, në një kohë kur zgjerimi është rikthyer në agjendën e Brukselit dhe ekziston një klimë më e favorshme për avancimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor.

Në "Përballje Podcast" në Telegrafi, Emini tha se aktualisht në krye të portofolit të zgjerimit ndodhet një komisionare që e mbështet fuqishëm procesin e integritetit të vendeve të rajonit por, sipas saj, Kosova nuk po e shfrytëzon këtë momentum. "Po humbet një moment tepër të rëndësishëm, sepse për momentin Marta Kos është një komisionare që e ka marrë zgjerimin seriozisht dhe po lobon për zgjerimin në Bruksel.



Nuk është e lehtë të lobosh për zgjerim në Bashkimin Evropian, sepse ka shtete që e mbështesin, por ka edhe vende që vazhdojnë të jenë skeptike", tha Emini gjatë diskutimit me kryeredaktorin Muhamet Hajrullahu. Ajo theksoi se brenda Bashkimit Evropian vazhdon debati nëse duhet të ketë zgjerim të mëtejshëm apo fillimisht reformim të brendshëm të unionit, duke përmendur

Francën si një nga shtetet që tradicionalisht ka favorizuar thellimin e integritetit para zgjerimit. Megjithatë, sipas saj, pikërisht në këtë periudhë Kosova ka pasur mundësi të kërkojë më fuqishëm avancimin e statusit të saj në raport me BE-në. "Në këto momente Kosova ka mundur të shtyjë përpara kërkesën për statusin e vendit kandidat. E kemi një Serbi që po

përballet me probleme të shumta dhe një Komision Evropian që është shumë më proaktiv sesa në të kaluarën", deklaroi ajo. Emini kritikoi qasjen e institucioneve të Kosovës, të cilat, sipas saj, po arsyetohen me mungesën e reagimit nga Brukseli, ndërkohë që problemi kryesor mbetet mungesa e lobimit dhe diplomacisë aktive. "Nuk ka lëvizje sepse nuk ka lobim. Bashkimi Evropian sot ka në tavolinë Ukrainën, Moldavinë, Turqinë dhe shumë sfida të tjera gjeopolitike. Nuk mjafton të thuash se kemi aplikuar dhe të presësh përgjigje", u shpreh ajo. Sipas Eminit, Kosova duhet të ndjekë një qasje më të guximshme dhe të kërkojë avancim të marrëdhënieve kontraktuale me BE-në pavarësisht faktit që pesë shtete anëtare ende nuk e njohin

pavarësinë e saj. "Kosova mund të argumentojë se, pavarësisht problemit me pesë vendet mosnjohëse, marrëveshjet ekzistuese me Bashkimin Evropian i lejojnë asaj të ndërtojë marrëdhënie kontraktuale me BE-në. Duhej të kërkonte hapjen e negociatave dhe kapitujve, ndërsa çështjet e tjera të trajtoheshin gjatë procesit", tha ajo. Emini vlerësoi se me përbërjen aktuale të Komisionit Evropian ekziston një mundësi reale për hapa të rinj në raportet Kosovë - BE, por theksoi se kjo kërkon angazhim të vazhdueshëm politik dhe diplomatik nga institucionet e Kosovës. "Kjo mund t'i jepej Kosovës. Me këtë Komision Evropian po. Por duhet angazhim, duhet vizion dhe duhet lobim i vazhdueshëm në Bruksel dhe në kryeqytetet evropiane", përfundoi Emini.



'PAGA KALIMTARE': MBI 150 MIJË EURO NË MUAJ PËR ISH-DEPUTETËT

Dhjetëra ish-deputetë të Kosovës përfitojnë nga 1.914 euro në muaj pa e ushtruar këtë funksion publik. Edhe pse paga kalimtare është e garantuar me ligj, ekspertët e shohin si të pajustificueshme nga pikëpamja etike dhe kërkojnë rishikim të skemës

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Në një kohë kur qytetarët e Kosovës përballen me rritje çmimesh dhe pasiguri ekonomike, mbi 150 mijë euro dalin nga buxheti i shtetit për një skemë që paguan ish-deputetët, edhe pasi ata nuk janë më pjesë e Kuvendit. Bëhet fjalë për të ashtuquajturën "pagë kalimtare", një përfitim që u garanton ish-deputetëve pagë mujore për një periudhë deri në 12 muaj pas përfundimit të mandatit, edhe nëse nuk janë rizgjedhur dhe nuk ushtrojnë më asnjë funksion parlamentar.

Një përfitim që i kushton shtetit miliona

Vetëm nga legjislatura e fundit - e cila u konstituua më 11 shkurt dhe u shpërnda më 28 prill - një ish-deputet mund t'i kushtojë buxhetit të shtetit rreth 23 mijë euro për një vit pa punuar fare në Kuvend. Aktualisht institucioni ligjvënës nuk është funksional, pasi është në pritje të konstituimit në bazë të rezultateve të dala nga zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 7 qershorit të cilat nuk janë certifikuar ende. Nga numri i përgjithshëm prej 120 deputetësh në muajin maj, 80 prej tyre kanë aplikuar për pagën kalimtare në vlerë prej 1.914 eurosh, sipas të dhënave të siguruara nga Kuvendi i Kosovës. Kjo përkthehet në rreth 153 mijë euro në muaj nga buxheti i shtetit, ose afërsisht dy milionë euro në vit.

E garantuar me ligj, e debatueshme nga aspekti etik

Paga kalimtare është e garantuar me ligj pavarësisht prej kohëzgjatjes së mandatit të deputetit apo faktit që disa nuk e ushtrojnë më atë funksion. Sipas Ligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit, ish-deputetët kanë të drejtë ta marrin këtë kompensim deri në momentin kur fillojnë të realizojnë të ardhura nga një burim tjetër ose pensioni, apo maksimumi 12 muaj. Organizatat që monitorojnë punën e Kuvendit thonë se legjislatura e fundit - e dhjeta me radhë - ka qenë e paefektshme. Sipas Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), gjatë periudhës shkurt-prill Kuvendi ka mbajtur 24 seanca, shumica të jashtëzakonshme, me vendimmarrje të shpejtë dhe pa debat substancial. Hulimtuuesi ligjor në IKD, Melos Kolshi, thotë se, ndonëse paga kalimtare është e ligjshme, ajo krijon hendek të qartë mes ligjit dhe etikës publike. Sipas tij, problemi qëndron në aplikimin pothuajse automatik të kësaj të drejte, në një realitet ku qytetarët përballen me papunësi, rritje të kostos së jetesës dhe paga të ulëta. Ai thekson se përgjegjësia nuk është vetëm ligjore, por edhe morale, duke nënvizuar se çdo ish-deputet duhet të vlerësojë

vetë nëse realisht ka nevojë për këtë kompensim. "Nëse një ish-deputet ka mundësi të kthehet menjëherë në profesionin e tij apo ka burime të tjera të të ardhurave, atëherë përfitimi i pagës kalimtare vetëm pse e lejon ligji, është vështirë të arsyetohet nga pikëpamja etike", thotë Kolshi për Radion Evropa e Lirë.

"E paarsyeshme në një ekonomi me sfida"

Në aspektin ekonomik, skema shihet edhe më kritike. Ish-gubernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, e konsideron këtë pagesë të paarsyeshme në kushtet aktuale ekonomike të vendit. Sipas tij, edhe pse qëllimi i saj është të lehtësojë tranzicionin e ish-deputetëve, kostoja prej rreth dy milionë eurosh në vit është vështirë të justifikohet në një ekonomi me inflacion dhe papunësi. "Dy milionë euro do të mund të orientoheshin në arsim, shëndetësi, mbështetje për të rinjtë, bursa studentore apo programe punësimi", thotë Mehmeti për Radion Evropa e Lirë. Sipas Fondit Monetar Ndërkombëtar, aktiviteti ekonomik në Kosovë është ngadalësuar, ndërsa inflacioni ka shënuar rritje gjatë vitit të fundit. Të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës tregojnë

se inflacioni në muajin maj ka arritur në 6.8 për qind, i nxitur kryesisht nga rritja e çmimeve të produkteve ushqimore. Ekonomia ka shënuar rritje prej 5.4 për qind në tremujorin e parë të këtij viti, por, sipas ekspertëve, rritja njëshifrore nuk është e mjaftueshme për të përmirësuar ndjeshëm mirëqenien e qytetarëve. Papunësia mbetet në nivelin 10.9 për qind, ndërsa paga mesatare mujore është 713 euro.

Thirrje për rishikim të ligjit

Mehmeti dhe Kolshi pajtohen se baza ligjore duhet të rishikohet, pa e hequr këtë të drejtë. Sipas Kolshit, problemi nuk është ekzistenca e pagës kalimtare, por mënyra se si është e dizajnuar. Ai propozon që periudha 12-mujore të rishikohet, sidomos kur mandatet parlamentare në praktikë mund të zgjasin shumë më pak. Një model më fleksibil, sipas tij, do të mund të ishte më i drejtë dhe më proporcional me kohëzgjatjen reale të mandatit. "Një periudhë fikse prej 12 muajsh mund të mos jetë gjithmonë e justifikuar, prandaj mund të shqyrtohet një afat më i shkurtër ose një model gradual që zvogëlon kompensimin me kalimin e kohës, varësisht se sa ka zgjatur legjislatura", thotë Kolshi. Mehmeti sugjeron kufizimin e pagës kalimtare në 3 deri në 6 muaj, ose lidhjen më të ngushtë

me kohëzgjatjen e shërbimit parlamentar. "Kjo do të rriste përgjegjshmërinë dhe transparencën në përdorimin e parasë së taksapaguesve... sepse, viteve të fundit, janë shpeshuar ciklet zgjedhore, e rrjedhimisht edhe pagesat", thekson ai.

Një sistem politik me cikle të shpeshta zgjedhore

Vetëm gjatë një viti e gjysmë të fundit, Kosova ka mbajtur tri palë zgjedhje parlamentare - një tregues i paqëndrueshmërisë politike që ndikon drejtpërdrejt edhe në barrën financiare të shtetit. Pas zgjedhjeve të 7 qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pritet t'i shpallë rezultatet përfundimtare deri në fund të muajit, ndërsa më pas pritet të konstituohet Kuvendi i ri. Sipas rezultateve preliminare, Lëvizja Vetëvendosje ka fituar 53 ulëse, Partia Demokratike e Kosovës 22, Lidhja Demokratike e Kosovës 18 dhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 7. Njëzet ulëse janë të garantuara për komunitetet pakicë - dhjetë për serbët, dhjetë për të tjerat. Nga legjislatura e fundit, 36 deputetë kanë mbetur jashtë Kuvendit, por numri përfundimtar i përfituesve të pagës kalimtare do të dihet vetëm pas formimit të Qeverisë, pasi disa deputetë pritet të emërohen ministra dhe të lirojnë mandatet.

EVROPA NË VALËN E TË NXEHTIT: TEMPERATURA DERI NË 44 GRADË

PARIS, 22 QERSHOR - Trembëdhjetë persona u mbytën gjatë fundjavës në Francë, duke notuar në zona të pambikëqyrura, në kushte të nxehtësisë ekstreme. Kjo valë e të nxehtit pritet të bëhet edhe më e fortë nga fillimi i kësaj jave, në shumë vende të Evropës, prandaj autoritetet kanë marrë masa të veçanta për mbrojtjen e njerëzve. Shumë aktivitete në ambiente të hapura janë anuluar, disa shkolla janë mbyllur, ndërsa shumë punonjëse u është kërkuar të punojnë nga shtëpia.

Në Francë, 49 nga 96 rajonet janë vendosur nën alarmin e kuq për nxehtësinë.

Sipas shërbimit meteorologjik Meteo-France, temperaturat mund të arrijnë deri në 43 gradë celsius në qytetin jugperëndimor Bordu dhe 39 gradë celsius në Paris.

Qeveria u ka bërë thirrje qytetarëve që të mos freskohen në zona të pambikëqyrura, si liqenet dhe lumenjtë, pas mbyetjeve të raportuara gjatë fundjavës - në mesin e tyre

edhe një vajzë 13-vjeçare.

Rreth 845 shkolla janë mbyllur të hënën për shkak të nxehtësisë, ndërsa 1 800 të tjera i kanë lejuar nxënësit të largohen më herët.

Në Belgjikë temperaturat këtë javë pritet të jenë "më të nxehtat ndonjëherë", paralajmëroi shefi i parashikimeve në institutin meteorologjik IRM, David Dehenaau.

Në Spanjë meteorologët paralajmërojnë nxehtësi shumë të madhe si ditën ashtu edhe natën, deri të mërkurën, me temperatura deri në 44 gradë celsius. Ata thonë se kjo është 5 deri në 10 gradë më shumë se normalja për këtë periudhë.

Në Portugali, temperaturat janë mbi mesataren, ndërsa në disa zona ato po u afrohen rekordeve të mëparshme.

Në Britani është dhënë paralajmërim për nxehtësi ekstreme, me temperatura që mund të kalojnë 35 gradë celsius.

Ekspertët thonë se rekordet e nxehtësisë në Britani për



muajin qershor pritet të thyhen.

Në Republikën Çeke dhe në pjesë të tjera të Evropës Qendrore, temperaturat janë gjithashtu mbi mesataren për këtë periudhë.

Në shumicën e vendeve të

Ballkanit, situata është e ngjashme me pjesën tjetër të Evropës: temperatura të larta dhe valë e fortë nxehtësie, me disa dallime nga vendi në vend. Kjo valë e të nxehtit është e dyta radhazi brenda dy muajve, pas një periudhe të pazakontë të

nxehtë në maj.

Shkencëtarët thonë se valët e përsëritura të të nxehtit janë një shenjë e qartë e ngrohjes globale dhe paralajmërojnë se ato do të bëhen më të shpeshta, më të gjata dhe më të forta.

RAMA NIS VIZITËN ZYRTARE NË PARIS, PRITET NË PALLATIN ELYSEE NGA PRESIDENTI MACRON



PARIS, 22 QERSHOR - Kryeministri Edi Rama ka nisur këtë të hënë vizitën zyrtare në Paris. Ai është prituri në Pallatin Elysee nga presidenti i Francës, Emmanuel Macron. Takimi është zhvilluar në kuadër të dialogut të vazhdueshëm mes dy vendeve

dhe pas disa takimeve të mëparshme mes dy liderëve, të mbajtura në Paris në prill 2024, si dhe në Tiranë në tetor 2023 dhe maj 2025.

Bisedimet e tyre janë përqendruar te perspektiva evropiane e Shqipërisë dhe ecuria e reformave

që vendi po zbaton në kuadër të procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Franca pritet ta riafirmojë mbështetjen e saj për vijimin e procesit të integritit të Shqipërisë në BE në përputhje me kriteret dhe parimet e unionit.

Në takim janë diskutuar çështje që lidhen me forcimin e bashkëpunimit dypalësh në fusha të ndryshme, përfshirë arsimin, ekonominë dhe energjinë.

Pritet të trajtohen edhe investimet franceze në Shqipëri, projekti për ndërtimin e një liceu francez në

Korçë, si dhe projektet e Agjencisë Franceze për Zhvillim (AFD) në sektorin e energjisë dhe të mjedisit.

Në fokus do të jenë edhe mundësitë për zgjerimin e bashkëpunimit në transport, infrastrukturë dhe mbrojtje.

40 raste me fruth në Kosovë, IKShPK bën thirrje për vaksinim të fëmijëve

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka njoftuar se gjatë periudhës 16 prill - 22 qershor në Kosovë janë regjistruar gjithsej 40 raste të konfirmuara me fruth. Sipas të dhënave zyrtare, shpërndarja e rasteve sipas komunave paraqitet si vijon: Ferizaj prin me 11 raste,

Prishtina me 9, Kaçaniku me 6, Fushë-Kosova me 3, ndërsa Lipjani, Vushtrria, Shtime dhe Obiliqi kanë nga 2 raste secila. Gjithashtu, nga një rast është raportuar në Gjilan, Drenas dhe Deçan.

IKShPK u bënë thirrje qytetarëve që të tregojnë kujdes dhe të paraqiten menjëherë në institucionet

shëndetësore në rast të shfaqjes së simptomave të dyshimta si temperaturë e lartë, skuqje apo ndryshime në lëkurë, kollë, rrufë dhe konjuktivit.

“Duke pasur parasysh infektueshmërinë e lartë të fruthit, rrezikun e përhapjes së tij në komunitet dhe komplikimet që shkakton

fruthi, IKShPK u bën thirrje prindërve dhe kujdestarëve që të verifikojnë statusin e vaksinimit të fëmijëve të tyre dhe të sigurojnë vaksinimin sipas Kalendarit të rregullt të imunizimit në qendrat e mjekësisë familjare. Vaksinimi mbetet masa më efektive dhe më e sigurt për parandalimin e fruthit, mbrojtjen e individëve



të pa-vaksinuar dhe ruajtjen e shëndetit publik”, thotë IKShPK.

PZAP-i RRËZOI ANKESËN E HAXHIUT DHE TË KRYEZIUT, KQZ-JA PRET AFATIN 48 ORËSH TË SUPREMES PARA SHPALLJES SË REZULTATEVE



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka bërë me dije se është në pritje të përfundimit të të gjitha procedurave ankimore para se t'i shpallë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës. Kjo vjen pasi Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP) ka refuzuar dy ankesat e paraqitura nga kandidati i PDK-së, Bekim Haxhiu, dhe kandidati i LDK-së, Qëndrim Kryeziu, të cilët kishin kërkuar rinumërim të votave.

Sipas vendimit të PZAP-it, ankesat janë konsideruar të pabazuara dhe nuk është

urdhëruar rinumërim shtesë i votave.

Zëdhënësi i KQZ-së, Valmir Elezi, ka konfirmuar se institucioni tashmë është njoftuar me vendimet e PZAP-it, por ka theksuar se palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën Supreme brenda afatit ligjor prej 48 orësh. “Mund t’ju konfirmoj se KQZ është njoftuar me vendimet e PZAP-it lidhur me dy ankesat e paraqitura në këtë institucion. Ndaj këtyre vendimeve palët kanë të drejtë ankese brenda 48 orëve në Gjykatën Supreme, andaj KQZ do të presë që vendimet ta marrin formën e prerë”, ka deklaruar ai. Sipas KQZ-së, vetëm pas

plotfuqishmërisë së vendimeve do të vlerësohet nëse ekzistojnë obligime konkrete për zbatim nga ana e institucionit.

Nëse nuk do të ketë vendime të tjera që ndikojnë në proces, atëherë KQZ do të procedojë me shpalljen e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve. Bekim Haxhiu kishte kërkuar rinumërim të plotë të votave të kandidatëve të PDK-së, duke argumentuar se gjatë rinumërimeve të deritanishme janë evidentuar mospërputhje në numërim dhe se diferencat e ngushta mes kandidatëve mund të ndikojnë në renditjen përfundimtare. Megjithatë, PZAP nuk e ka mbështetur këtë kërkesë.

GAZI AMERIKAN, KRYEZIU: ASNJË QEVERI NUK DUHET TË MARRË E VETME VENDIME QË PËRCAKTOJNË ORIENTIMIN STRATEGJIK TË KOSOVËS

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Drejtori i Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), Ismet Kryeziu, ka komentuar refuzimin e projektit amerikan të gazit nga qeveria, duke vlerësuar se vendime të tilla me ndikim afatgjatë nuk duhet të merren vetëm nga një qeveri. Ai ka theksuar se asnjë ekzekutiv nuk duhet të përcaktojë i vetëm orientimin energjetik, ekonomik dhe strategjik të Kosovës për dekada.

Kryeziu ka shkruar në “Facebook” se një investim strategjik në sektorin e gazit nga kompani amerikane nuk paraqet vetëm një projekt ekonomik, por lidhet edhe me sigurinë energjetike dhe partneritetin strategjik me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. “Pavarësisht legjitimitetit që buron nga vota, asnjë qeveri nuk duhet të marrë e vetme vendime që mund të përcaktojnë orientimin energjetik, ekonomik

dhe strategjik të vendit për dekada. Investimi strategjik në sektorin e gazit nga kompani amerikane nuk është thjesht një projekt ekonomik. Ai prek sigurinë energjetike të Kosovës, zhvillimin afatgjatë ekonomik, sigurinë kombëtare, përfshirjen e vendit në iniciativa rajonale dhe partneritetin strategjik me SHBA-në”, ka shkruar Kryeziu. Sipas tij, për shkak të rëndësisë së një vendimi të tillë, procesi duhet të shoqërohet me debat të gjerë publik, transparencë dhe përfshirjen e ekspertëve, komunitetit të biznesit, shoqërisë civile dhe aktorëve të tjerë relevantë. “Një vendim i tillë nuk duhet të kalojë pa debat të gjerë publik, pa transparencë të plotë dhe pa përfshirjen e komunitetit të biznesit, ekspertëve të fushës, shoqërisë civile, partive politike dhe aktorëve të tjerë relevantë”, ka shkruar Kryeziu.



Afër 3 000 tonë mbetje largohen nga deponitë ilegale në pesë rajone të vendit

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Afër tre mijë tonë mbetje janë larguar nga deponitë ilegale në pesë rajone të vendit gjatë katër javëve të para të Aksionit Kundër

Mbeturave i cili është duke u zbatuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. “Afër tre mijë tonë mbetje janë larguar nga deponitë ilegale në pesë

rajone gjithandej vendit, nga Prishtina e Prizreni, Ferizaj, Peja e Mitrovica, për katër javë që kur ka nisur Aksioni Kundër Mbeturave. Aksioni i Ministrisë së

Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor po zgjerohet me ritëm të shtuar, sikurse edhe zgjerimi në komunat dhe rajonet tjera”, ka njoftuar kjo ministri.



FSK-ja teston gatishmërinë fizike dhe luftarake në garën "Forca 2026"



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Komanda e Logjistikës në bashkëpunim me dy regjimentet e saj realizoi garën ekipore "Forca 2026" në kuadër të Planit Vjetor të Aktiviteteve për vitin 2026. Gara u zhvillua në katër disiplina të ndryshme, me pjesëmarrjen e shtatë ekipeve nga Komanda e Logjistikës dhe njësitë e saj

varëse. Qëllimi i kësaj gare ishte testimi i përgatitjes fizike dhe qëndrueshmërisë luftarake ndërmjet pjesëtarëve të njësisë. Gjatë zhvillimit të garës pjesëmarrësit demonstuan nivel të lartë profesionalizmi, disipline, përkushtimi dhe gatishmërie fizike, duke dëshmuar rëndësinë e stërvitjes

së vazhdueshme dhe të punës ekipore për përmbushjen e detyrave ushtarake. Aktiviteti u përmbyll me shpalljen e ekipeve më të suksesshme dhe ndarjen e mirënjohjeve për pjesëmarrësit, duke reflektuar frymën e garës së ndershme, profesionalizmit dhe bashkëpunimit.

DY POLICË NGA BRANDENBURG-U PËRFUNDOJNË PRAKTIKËN NË POLICINË E KOSOVËS


EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Policia e Kosovës ka përmbyllur me sukses të lartë programin dyjavor të shkëmbimit të përvojave dhe praktikës profesionale në kuadër të bashkëpunimit të shkëlqyeshëm me Universitetin Policor të Brandenburg-ut nga Gjermania. Policia e Kosovës ka njoftuar se "nga data 8 deri më 19 qershor 2026, institucioni ynë priti dy zyrtarë policorë nga ky universitet gjerman, duke shënuar hap shumë të rëndësishëm në konsolidimin e marrëdhënieve akademike dhe trajnuese profesionale ndërmjet dy vendeve". Po ashtu, ajo ka bërë me dije se ky program shërbeu si një platformë e shkëlqyeshme promovuese për të shfaqur kapacitetet tona të larta institucionale dhe standardet moderne evropiane që Policia e Kosovës reflekton në rrafshin ndërkombëtar. Gjatë

kësaj periudhe, zyrtarët policorë gjermanë realizuan vizita të rëndësishme dhe bashkëbisedime të nivelit të lartë profesional në Departamentin e Njësisë Speciale, Departamentin e Hetimeve, Departamentin e Kufirit, Departamentin e Rendit Publik dhe Drejtorinë për Bashkëpunim Ndërkombëtar, ku analizuan nga afër metodologjitë bashkëkohore të policimit

operativ dhe strategjik. Agjenda zyrtare përfshiu gjithashtu një vizitë të veçantë në Ambasadën Gjermane në Prishtinë, si një konfirmim i mbështetjes së ndërsjellë diplomatike dhe bashkëpunimit të palëkundur bilateral në fushën e sigurisë. Zyrtarët policorë nga Gjermania patën rastin të shohin dhe të vizitojnë edhe vende të kulturës



dhe historisë sonë të lavdishme. Ky proces i rëndësishëm i shkëmbimit akademik dhe taktik u menaxhua me profesionalizëm të lartë nga mentorët e Departamentit të Burimeve Njerëzore/Divizionit të Trajnimeve, duke gëzuar përkrahjen e plotë të autoritetit të drejtorit të Përgjithshëm dhe menaxhmentit të lartë të Policisë së Kosovës.

Përmes këtij suksesi Policia e Kosovës rikonfirmon përkushtimin e vazhdueshëm për të ardhmen që të thellojë këtë partneritet strategjik me palën gjermane, duke synuar projekte të reja të përbashkëta akademike, shkëmbim të mëtutjeshëm të ekspertizës dhe avancim të Përgjithshëm dhe standardeve profesionale policore.

MODERATORJA ALKETA GASHI-FAZLIU NDEROHET ME ÇMIMIN 'GAZETARJA E VITIT' NGA UNIVERSITETI I TEKSASIT NË DALLAS



PRISHTINË, 22 QERSHOR - Universiteti i Teksasit në Dallas të ShBA-së (UTD) ia ndau ish-studentes së Universitetit të Prishtinës dhe moderatores së njohur të RTK-së, Alketa Gashi-Fazliu, çmimin "Orpheus Texts Journalist of the Year 2025". Çmimi ndërkombëtar Gashi-Fazliut i është dhënë nga shtëpia botuese "Mundus Artium Press" me seli në Universitetin e Teksasit në Dallas dhe i është dorëzuar nga drejtori i saj, Gjekë Marinaj. Gjatë ceremonisë fjalë përshëndetëse mbajtën

prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, prof. Rozafa Basha, ambasadori i parë i Kosovës në ShBA, Avni Spahiu, Zymer Neziri, profesori i Universitetit të Teksasit, Gjekë Marinaj, mësimsdhënësja Agnesa Çipa dhe laureatja e çmimit, Alketa Gashi-Fazliu. Ajo e cilësoi Universitetin e Prishtinës si vendin ku është brumosur. Pas ceremonisë, prorektorja Basha u takua me drejtorin e "Mundus Artium Press" dhe profesorin e disertacioneve dhe hulumtimeve ndërkombëtare

me bazë në Universitetin e Teksasit në Dallas, Gjekë Marinaj. Në takim u fol për mundësitë e bashkëpunimit mes Universitetit të Prishtinës, Universitetit të Teksasit në Dallas dhe institucioneve të tjera të arsimit të lartë nga bota në të cilat punon profesori Marinaj. Profesori Marinaj tha se është kënaqësi dhe nder që ta shfrytëzojë gjithë autoritetin e tij për të krijuar lidhje e rrjetëzim të UP-së me institucionet ku jep mësim dhe me të cilat ka kontakte.

Kampi "Enver Zymeri" do të rinovohet, policia hap tender në vlerë rreth 16 mijë euro

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Policia e Kosovës ka hapur një tender të ri në kuadër të procedurave të prokurimit publik për rinovimin e kampit "Enver Zymeri". Sipas dokumentit zyrtar, afati për dorëzimin e ofertave është i

hapur deri më 2 korrik 2026 ora 14:00. Autoriteti kontraktues ka bërë me dije se procedura synon furnizimin e nevojshëm për funksionimin e rregullt të institucionit në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore

të prokurimit publik. Sipas dokumentacionit të publikuar, kontrata është e kategorisë së furnizimit dhe ka për qëllim sigurimin e materialeve të nevojshme për realizimin e punimeve rinovuese në këtë qendër.

Vlera e parashikuar e kontratës është 15 927.50 euro, ndërsa projekti synon përmirësimin e kushteve infrastrukturore dhe funksionale të objektit. Rinovimi i këtij kampi ka ardhur pas raportimit në media për gjendje të rëndë të

tij. Në disa media janë publikuar fotografi ku shihen dyer dhe dritare të thyera dhe pjesë të tjera të objektit tejet të dëmtuara, e ku zyrtarët policorë të Njësisë Speciale qëndrojnë gjatë punës së tyre.

Më shumë sipërfaqe e shfrytëzuar e tokës bujqësore më 2025 sesa më 2024

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar rezultatet e Anketës së Ekonomive Bujqësore (AEB) për vitin 2025. Të dhënat tregojnë se sipërfaqja e përgjithshme e shfrytëzuar e tokës bujqësore u rrit për 510,90 ha (0,1 %) në vitin 2025 krahasuar me vitin 2024.

Nga gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore në vitin 2025, pjesa më e madhe iu përket livadheve dhe kullosave (përfshirë tokën e përbashkët) ishte 216 697,39 ha krahasuar me vitin paraprak

2024 (që ishte 216 534,33 ha). Rritja e sipërfaqes te toka e përbashkët si rezultat i rritjes së numrit të blegtorisë.

Toka e punueshme - arat marrin pjesë me 45 % në gjithsej sipërfaqja e shfrytëzuar e tokës bujqësore dhe kopshtet me 0,2%.

Gjatë vitit 2025, gjithsej toka e punueshme - arat, ishte 189 131,22 ha, pjesa më e madhe ishte me: drithëra (128 190,63ha, ose 67,8%); bimë foragjere (36 446,35 ha, ose 19,3%); perime 9 841,44 ha në fushë të hapur, në serra dhe kopshte (prej të cilave perime

në fushë të hapur dhe serra ishin 8 946,37ha, ose 4,7%); patate (3 375,16ha, ose 1,8%); bishtajore (2 257,45ose 1,2%); bimë industriale (1 254,60ha, ose 0,7%); kultura të tjera (2 556,27ha, ose 1,4%) dhe tokë djerrinë ishte 6 104,38 ha ose 3,2%.

Sipërfaqe e ujitur, të paktën një herë gjatë periudhës referuese të anketës në vitin 2025, ishte 34 240,28 ha.

Kurse gjithsej sipërfaqja e trajtuar me pesticide në vitin 2025 ishte 123 045,50 ha.

Rezultatet e kësaj ankete tregojnë se blegtoria në Kosovë



gjatë vitit 2025 sa i përket numrit të gjedheve ishte 241 423, që krahasuar me vitin paraprak 2024 (që ishte 240 848), ka rritje të lehtë.

Sa i përket numrit të deleve gjatë vitit 2025 ishte 211 178, që krahasuar me vitin paraprak 2024 (që ishte 209 947) vërehet rritje e lehtë.

HAPEN APLIKIMET PËR SUBVENCIONET BUJQËSORE 2026, MUJA FTON FERMERËT TË APLIKOJNË

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Armend Muja, ka njoftuar të hënën se është hapur zyrtarisht aplikimi për Programin e Pagesave Direkte 2026 i cili konsiderohet programi kryesor për mbështetjen e prodhimit bujqësor në Kosovë. Sipas tij, programi i këtij viti paraqet një hap të rëndësishëm në reformimin e politikave mbështetëse në bujqësi dhe harmonizimin gradual të tyre me, siç ka thënë, parimet e Politikës së Përbashkët Bujqësore të Bashkimit Evropian.

Në një njoftim në "Facebook", Muja ka shkruar se "programi është ndërtuar për ta mbështetur fermerin aktiv, për ta forcuar prodhimin vendor, për ta rritur cilësinë e prodhimit dhe për të krijuar kushte më të



mira për zhvillimin e fermave familjare dhe të gjeneratës së re të fermerëve".

Sipas këtij postimi, fermerët do të mund të përfitojnë nga katër shtylla kryesore të mbështetjes: pagesa për të ardhura për sipërfaqet e pranueshme bujqësore, pagesa rishpërndarëse për fermat e

vogla dhe të mesme si dhe fermerët e rinj, pagesa të lidhura me prodhimin dhe cilësinë për sektorët prioritarë të bujqësisë dhe eko-skemat për prodhimin organik dhe praktikatat e qëndrueshme bujqësore. Muja theksoi se programi i këtij viti vendos fokus të veçantë të prodhimit, rendimenti dhe

cilësia, duke orientuar një pjesë të konsiderueshme të mbështetjes drejt fermerëve që prodhojnë, investojnë dhe kontribuojnë në zhvillimin e tregut vendor.

"Synimi ynë është ta rrisim konkurrueshmërinë e sektorit bujqësor, ta forcojmë sigurinë ushqimore dhe të krijojmë më shumë mundësi zhvillimi për zonat rurale", ka shkruar ai në "Facebook".

Muja ka bërë me dije se periudha e aplikimit do të zgjasë nga 22 qershori deri më 21 korrik 2026, deri në orën 16, ndërsa aplikimet do të pranohen në drejtoritë komunale për bujqësi në të gjitha komunat e Kosovës. Ministri u ka bërë thirrje fermerëve që të aplikojnë me kohë dhe të sigurohen që të dhënat e deklaruara për sipërfaqet, kulturat bujqësore, kafshët, kosheret dhe prodhimin

të jenë në përputhje me gjendjen reale në fermë.

Ai ka rikujtuar se kafshët duhet të jenë të identifikuar dhe të regjistruara sipas kërkesave ligjore, ndërsa për sektorët ku kërkohen dëshmi të prodhimit dhe shitjes, dokumentacioni duhet të ruhet dhe dorëzohet brenda afateve të përcaktuara.

Sipas Mujës, Programi i Pagesave Direkte 2026 do të zbatohet me standarde të larta të transparencës, kontrollit dhe llogaridhënies, përmes verifikimeve administrative, kontrolleve në terren dhe monitorimit të parcelave bujqësore.

Ministri u ka bërë thirrje fermerëve që për informata shtesë t'u drejtohen drejtorive komunale për bujqësi, Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë.

NGRITJA E TEMPERATURAVE, A DO TË RIKTHEHET VENDIMI QË KUFIZON ORARIN E PUNËS?

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Temperaturat e larta po kthehen, e bashkë me to edhe rreziku për ata që janë më të ekspozuar në rrezet e diellit: punëtorët e sektorit të ndërtimtarisë. Për këtë, Bashkimi i Sindikatave të Pavarura ka kërkuar rikthimin në fuqi të vendimit të Ministrisë së Shëndetësisë që, mes të tjerash, kufizon orarin e punës dhe lironte nga puna kategori të caktuara.

Rrezik serioz për sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve i konsideron temperaturat

ekstreme eksperti i sigurisë në punë, Arian Ibishi, teksa përmend edhe obligimet e punëdhënësve për punëtorët. "Sigurimi i ujit të pijshëm në sasi të mjaftueshme duhet të jetë kyç, pushime të rregullta në vendet e punës ku mundet me pas edhe hije të freskëta, shmangien e punëve të rënda gjatë procesit të punës", ka thënë Ibishi.

Për efektet flet mjeku familjar Rushit Ismajli, që përmend edhe profesione të tjera që mund të preken. "Ata të cilët punojnë në ndërtimtarinë, në bujqësi apo edhe



në ambiente të mbyllura, në kuzhina, mund të ngulfaten për shkak të mungesës së avullimit të tyre, mund të shkaktojë marramendje, mund të shkaktojë mundim apo në raste ekstreme edhe humbje të vetëdijes", ka thënë Ismajli.

Përveç punëtorëve të ekspozuar direkt në reze dielli, Ismajli përmend edhe kategori të tjera që mund të kenë telashe shëndetësore. "Ne zakonisht flasim për grupmoshat që janë më të rrezikuara, si fëmijët, gratë shtatzëna, personat me sëmundje kronike, sidomos me hipertension, por të rrezikuar më shumë janë punonjësit e ndërtimtarisë, sepse ata qëndrojnë në temperatura të larta", ka shtuar Ismajli.

Në dy vitet paraprake Ministria e Shëndetësisë, kryesisht në muajin korrik, ndër të tjera,

kishte ndërmarrë masa kufizuese, duke ndaluar punën nga ora 11:00 deri në orën 17:00. Me vendim të ministrisë liroheshin nga puna shtatzënat e shkurtrohej orari për qytetarët me sëmundje kronike.

Nga ky institucion për Dukagjinin thanë që deri më tani nuk kanë pranuar rekomandime nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike për marrje të masave. Temperaturat e larta tashmë kanë prekur disa vende evropiane, ku edhe janë regjistruar viktima. (Dukagjini)

Skemat sociale: Numri më i madh i përfituesve në maj i takoi skemës së shtesave për fëmijë

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar statistikat e mirëqenies sociale për muajin maj 2026. Numri më i madh i përfituesve në maj 2026 ishte

skema e shtesave për fëmijë (numri i përfituesve: 405 935). Sipas të dhënave të muajit maj 2026, struktura e përfituesve nga skemat e mirëqenies sociale, kryesisht ka në fokus mbështetjen e të moshuarve,


kategoritë e dala nga lufta dhe familjet në nevojë.

Skemat e tjera përfshijnë pensionet familjare, pensionet paraplegjike dhe tetraplegjike, pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe

invalidëve të luftës, pensionet e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pensionet e Trepçës, programi për mbështetje financiare për shtesat për fëmijë si dhe skema të tjera specifike sociale.



NGA FORCAT SPECIALE TE PALLATI MBRETËROR, HISTORIA E JASHTËZAKONSHME E NJERIUT TË BESUAR QË PLANIFIKOI DASMËN E WILLIAM DHE RUAJTI SEKRETET E HARRYT



Ish-oficeri i forcave speciale SAS (Forcat Ajrore Speciale) dhe ish-këshilltari i familjes mbretërore britanike, Jamie Lowther-Pinkerton, është rikthyer në vëmendjen publike pasi ka publikuar një roman, duke sjellë në qendër të interesit edhe karrierën e tij të pazakontë pranë Familjes Mbretërore të Britanisë. Në një artikull të The Times zbulohet se Lowther-Pinkerton, i njohur si një nga figurat më të besuara brenda rrethit të ngushtë të Mbretit Charles III dhe më parë edhe i Princit William dhe Princit Harry, ka shërbyer për dekada në role kyçe brenda pallatit mbretëror, duke përfshirë organizimin e eventeve madhore dhe menaxhimin e situatave të ndjeshme familjare. Ai ka qenë edhe ish-asistent i Nënës Mbretëreshës, një rol që, sipas tij, e futi për herë të parë në botën e jetës mbretërore dhe i dha akses të drejtpërdrejtë në strukturat më të brendshme të oborrit. Para se të bëhej figurë e besuar në pallatin mbretëror, Lowther-Pinkerton kishte shërbyer në ushtrinë britanike dhe në forcat

speciale SAS, ku ishte dekoruar për operacione kundër një karteli droge në Kolumbi. Kjo karrierë ushtarake e bëri atë një figurë të fortë dhe të aftë për të menaxhuar situata me rrezik të lartë dhe protokolle të ndjeshme. Më vonë, ai u përfshi në detyra pranë familjes mbretërore, duke u bërë një nga këshilltarët më të afërt të Princave William dhe Harry, si dhe një figurë kyçe në përgatitjen e tyre për jetën publike.

Brenda "rrethit të brendshëm" të mbretërisë

Lowther-Pinkerton ka treguar se puna me familjen mbretërore kërkonte fleksibilitet të madh, duke e përshkruar veten si dikë që duhej të ishte herë "i ashpër si ushtar" dhe herë diplomatik si këshilltar. Ai ka qenë i përfshirë në organizimin e dasmës mbretërore të vitit 2011 të Princit William dhe Kate Middleton, si dhe në detyra të tjera protokollare të rëndësishme. Në kujtimet e tij, ai përshkruan marrëdhënien me Princin

William si atë të një lideri natyral, ndërsa Princin Harry si më impulsiv dhe të gjallë. Megjithatë, ai ka theksuar se i ka respektuar dhe vlerësuar të dy. Ai ka luajtur gjithashtu rol në menaxhimin e disa situatave delikate, përfshirë edhe ndihmën që i është dhënë Princit Harry pas skandaleve publike, duke e shoqëruar në udhëtime edukative dhe takime simbolike.

Marrëdhëniet me Harry dhe William

Në intervista të mëparshme dhe në kujtime të botuara nga vetë Prince Harry, Lowther-Pinkerton përshkruhet si një figurë e qetë dhe e besueshme brenda pallatit, dikush që "nuk merrej me marrëzira" dhe që ruante gjithmonë një qëndrim profesional. Megjithatë, kur u pyet për ndarjen e thellë mes Princit Harry dhe Princit William, ai ka refuzuar të komentojë, duke theksuar se preferon të qëndrojë larg kësaj çështjeje, pavarësisht lidhjeve të tij të ngushta me të dy.

Sot, në moshën 65-vjeçare, Lowther-Pinkerton ka vendosur të nisë një kapitull të ri si shkrimtar. Romani i tij i parë trajton një histori dashurie në sfondin e Luftës së Dytë Botërore, duke ndërthurur elemente historike dhe personale të frymëzuara nga familja e tij dhe përvojat në shërbimet inteligjente. Ai ka thënë se ideja e romanit lindi nga përvojat e jetës së nënës së tij, e cila ka shërbyer në inteligjencën ushtarake gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe më pas në shërbimet britanike të sigurisë.


Një jetë mes disiplinës dhe aristokracisë

Gjatë karrierës së tij, Lowther-Pinkerton ka pasur kontakte edhe me figura të njohura publike dhe mbretërore, përfshirë Princess Diana, si dhe ka marrë pjesë në evente shtetërore dhe udhëtime zyrtare të familjes mbretërore. Ai është i njohur në qarqet mbretërore si një figurë e

drejtpërdrejtë dhe pa filtra, por edhe si një nga njerëzit më të besuar për menaxhimin e situatave të ndjeshme brenda pallatit.

Një figurë e rrallë në oborrin britanik

Historia e tij përmbledh një rrugëtim të pazakontë: nga operacionet ushtarake dhe SAS, te korridoret e pallatit mbretëror, dhe tani në botën e letërsisë. Ai mbetet një nga figurat që ka kaluar më shumë kohë pranë familjes mbretërore në role joformale, duke u shndërruar nga punonjës në mik i afërt i saj. Sot, ai thotë se ende mban lidhje të forta me familjen mbretërore dhe se roli i tij si kumbar i Princit George dhe marrëdhëniet me brezin e ri të familjes vazhdojnë të jenë pjesë e jetës së tij. Romani i tij i ri shihet si vetëm fillimi i një kapitulli të ri për një njeri që ka jetuar mes botës së ushtarakëve, aristokracisë dhe politikës britanike.



QENDRA SPORTIVE
'BUJOËSIA'
TEL: 045/82 82 82

AMIR SHAIPI PRITET TË TRANSFEROHET NË TURQI

LUGANO, 22 QERSHOR - Portieri i Kombëtares së Kosovës, Amir Shaipi, duket se është pranë largimit nga Lugano pas pesë vitesh të kaluara te klubi zviceran. 25-vjeçari i ishte bashkuar Luganos nga Schaffhausen në vitin 2021 dhe gjatë kësaj periudhe është shndërruar në një nga portierët më të rëndësishëm të skuadrës, duke regjistruar plot 180 paraqitje me fanellën bardhezi. Një nga çastet më të

veçanta të karrierës së tij me Luganon ishte triumfi 4-1 ndaj St. Gallenit në finalen e Kupës së Zvicrës në maj të vitit 2022. Megjithatë, situata e tij ka ndryshuar sezonin e kaluar pas ardhjes në huazim të David von Ballmoos, i cili ka marrë rolin e portierit të parë. Pavarësisht prej kësaj, mungesat e shpeshta të zvicranit i kanë mundësuar Shaipit të grumbullonte gjithsej 28 paraqitje gjatë

sezonit. Lugano ka vendosur ta transferojë përfundimisht David von Ballmoos, gjë që ka shtuar gjasat që Shaipi të largohet këtë verë, një vit para skadimit të kontratës së tij. Sipas gazetarit turk Resat Can Ozbudak, portieri nga Kosova ka arritur marrëveshje me Amed SK, skuadër që ka siguruar ngjitjen në Superligën e Turqisë për sezonin e ardhshëm. Nëse transferimi finalizohet,

kjo do të jetë aventura e parë e Shaipit jashtë futbollit zviceran. Në vitet e zhvillimit të tij ai ka qenë pjesë e akademive të Schaffhausenit, Winterthurit dhe Grasshopperit. Kalimi në Turqi mund të përfaqësojë një hap të rëndësishëm në karrierën e portierit të Kosovës, i cili synon të rikthehet si titullar i padiskutueshëm dhe ta vazhdojë zhvillimin e tij në një kampionat më konkurrues.



MBAPPE: MESSI DHE RONALDO JANË MË TË MIRËT NË BOTË

BOSTON, 22 QERSHOR - Kapiteni i Francës, Kylian Mbappe, ka deklaruar se Lionel Messi dhe Cristiano Ronaldo mbeten dy prej futbollistëve më të mirë në botë gjatë Kupës së Botës 2026, duke minimizuar krahasimet me veten dhe duke theksuar se prioriteti i tij është suksesi i kombëtares franceze. Në një konferencë për medie, sulmuesi i Real Madridit është

pyetur për garën mes yjeve më të mëdhenj të futbollit si dhe për mundësinë që ta thyejë rekordin e golashënuesit më të mirë në historinë e Botërorëve. "Messi është lojtari më i mirë, së bashku me Cristianon, kjo është e qartë. Unë po përpiqem vetëm ta ndihmoj ekipin tim të fitojë një tjetër Kupë Bote. Të gjitha të tjerat janë tema për gazetarët", ka



deklaruar Mbappe. Francezi ka shtuar se nuk mendon për rekorde individuale apo rivalitete me

sulmues të tjerë, pasi fokusi i tij është te ndeshja e radhës dhe objektivat e kombëtares. "E dija që Leo do të shënonte, sepse ai gjithmonë shënon. Nëse realizon gola, afroresh me rekordet, por për mua gjëja më e rëndësishme është ta fitojmë Kupën e Botës", është shprehur ai. Mbappe ka folur edhe për evolucionin taktik të futbollit

modern, duke vlerësuar ndikimin që skuadrat fituese kanë në mënyrën se si luhet loja. "Skuadrat që fitojnë gjithmonë bëhen shembull për të tjerët. Dikur të gjithë donin ta kopjonin Barcelonën, më pas Real Madridin dhe tani PSG-në. Por futboli i kombëtareve është krejtësisht ndryshe", ka theksuar sulmuesi francez.

HEROI I KEPIT TË GJELBËR QË PUSHTOI GLOBIN NË KUPËN E BOTËS 2026

TAMPA, 22 QERSHOR - Një nga bukuritë e Kupës së Botës 2026 është fama që po përjetojnë lojtarë që deri dje ishin pothuajse të panjohur, por që tani po shkëlqejnë në skenën më të madhe të futbollit, duke përfaqësuar kombëtare që konsiderohen si "hirushja" e turneut. Askush nuk e ilustron më mirë këtë fenomen sesa portieri i Kepit të Gjelbër, Vozinha. Heroizmat e tij kundër Spanjës, në barazimin 0:0, e kanë kthyer 40-vjeçarin në një sensacion të vërtetë, ndërsa numri i ndjekësve të tij në "Instagram" është rritur në mënyrë marramendëse brenda pak orësh. I habitur dhe duke qeshur nga mosbesimi, Vozinha pa sesi 50 mijë ndjekësit e tij janë shndërruar në miliona. Vetëm

24 orë pas ndeshjes, kjo shifër kishte arritur në 10 milionë. Për krahasim, ai tashmë ka më shumë ndjekës sesa ylli francez i NBA-së, Victor Wembanyama (6.2 milionë), apo quarterback-u i NFL-së, Patrick Mahomes (6.4 milionë). "Çmenduri! Kjo është çmenduri", është shprehur Vozinha për kanalin brazilian në "YouTube", "CazeTV", pas ndeshjes që e shndërroi atë në një nga emrat më të përfolur të Kupës së Botës deri më tani. Megjithatë, emocionet e Vozinhës nuk kishin të bënin vetëm me historinë që ai dhe Kepi i Gjelbër po shkruanin në fushë. Ai është përplotur edhe për mungesën e nënës së tij në stadium, e cila nuk kishte mundur të udhëtonte për shkak të problemeve me vizën.



Nga një portier pak i njohur i një kombëtareje të vogël, Vozinha është shndërruar brenda pak ditësh në një nga figurat më të dashura dhe më të njohura të Kupës së Botës 2026.

Botërori thyen çdo parashikim: Dy milionë tifozë në stadione pas 36 ndeshjeve të para

NJU-JORK, 22 QERSHOR - Kupa e Botës 2026 ka tejkaluar çdo parashikim dhe ka hedhur poshtë dyshimet e ngritura në prag të nisjes së turneut, sa i përket interesimit të tifozëve dhe organizimit. Pas 36 ndeshjeve të para të zhvilluara, numri i tifozëve që i kanë ndjekur sfidat nga tribunat e stadioneve ka arritur në

shifrën mbresëlënëse prej dy milionë personash. Ky interesim i jashtëzakonshëm dëshmon entuziazmin e madh që ka ngjallur Kupa e Botës 2026, duke iu përgjigjur me fakte kritikëve dhe skepticizmit që e kishte shoqëruar turneun para fillimit të tij. Pjesëmarrja masive e tifozëve në stadione konfirmon se Botërori po rezulton një sukses i madh në aspektin e audiencës, duke krijuar atmosferë spektakolare dhe duke forcuar statusin e tij si ngjarja më e madhe sportive në botë.



Lamine Yamal hyn në historinë e Kupës së Botës

CHATTANOOGA, 22 QERSHOR - Lamine Yamal vazhdon të thyejë rekorde me fanellën e Spanjës, teksa tani ka hyrë në mesin e 10 golashënuesve më të rinj në historinë e Kupës së Botës. Ylli i Barcelonës ka realizuar golin e parë në fitoren 4-0 të Spanjës ndaj Arabisë Saudite në Atlanta,

duke zhbllokuar rezultatin që në minutën e 11-të të takimit. Përveç rëndësisë në ndeshje, ky gol ka hyrë edhe në histori. Në moshën 18 vjeç e 343 ditë, Yamal është bërë zyrtarisht golashënuesi i tetë më i ri në historinë e Kupës së Botës. Ai ka lënë pas emra të mëdhenj të futbollit si Lionel Messi dhe

Julian Green, ndërsa në listën elitare vazhdon të kryesojë legjenda braziliane Pele. Yamal kishte nisur nga banka rezervë ndeshjen e parë të Spanjës në Kupën e Botës kundër Kepit të Gjelbër për shkak të një shqetësimi të lehtë në kofshë, por u rikthye titullar ndaj Arabisë Saudite dhe tregoi

menjëherë rëndësinë e tij. Me këtë gol, talenti i Barcelonës jo vetëm që ndihmoi Spanjën të sigurojë një fitore të rëndësishme, por edhe shtoi një tjetër rekord në karrierën e tij të jashtëzakonshme, e cila vazhdon të marrë përmasa historike pavarësisht prej moshës së re.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

